



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

NJOFTIM PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE TË AGJENCIVE TRAJNUESE PËR TRAJNIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRANË KOMISIONIT TË AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT (FAZA 1)

Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit (KAPT), bazuar në udhëzimin nr.16, datë 28.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” dhe në dokumentin nr. 4186/4 prot, datë 30.08.2021 “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, njofton të gjitha agjencitë trajnuese (përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë) që mbulojnë profilin e mësuesisë dhe që janë të interesuara për të organizuar trajnime me punonjës të arsimit të sistemit parauniversitar, se ***ka hapur procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.***

Aplikimi i agjencive trajnuese për të akredituar programe/module trajnimi **kalon në dy faza:**

- Faza e parë është faza e përzgjedhjes paraprake, në të cilën agjencia trajnuese shpreh interesin dhe dorëzon kërkesën e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës.
- Faza e dytë është faza kur të gjitha agjencitë trajnuese që kalojnë fazën e parë, dorëzojnë programet/modulet e trajnimit në përputhje me nevojat e punonjësve arsimorë për zhvillim profesional.

Dokumentacioni i aplikimit të fazës së parë përmban:

- Formati i aplikimit i plotësuar sipas ***shtojcës 2. Bashkëlidhur dokumentacioni juridik dhe CV-të e trajnerëve për çdo modul sipas modelit EUROPASS.***
- Lista përmbledhëse për të gjitha modulet (***shtojca 3***).

Tematika e programeve dhe moduleve të trajnimit bazohet në **fushat dhe çështjet kryesore** të paraqitura në dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025”.

Në fazën e parë agjencitë trajnuese/IAL-të dorëzojnë kërkesën për aplikim me postë në adresën postare të ASCAP-it, pranë Sekretariatit të KAPT, “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar), Rruga: Naim Frashëri nr. 37” , **brenda datës 04.10.2021.**

Shënim: Dosjet që dorëzohen mbas kësaj date nuk do të shqyrtohen nga KAPT.

Agjencitë që aplikojnë mbajnë përgjegjësi për plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të tyre. Për një informacion më të detajuar konsultoni legjislacionin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të ASCAP-it: www.ascap.edu.al

Agjencitë trajnuese që do të kalojnë fazën e parë do të njoftohen për vijimin e procesit të aplikimit të programeve/moduleve të trajnimit në një njoftim të dytë.

Për sqarime specifike lidhur me procesin e aplikimit mund të komunikoni në adresat e email: sekretaria@ascap.edu.al; katsekreteriatit@gmail.com ose mund të kontaktoni znj. **Gentjana Marku (juriste, ASCAP) me cel: 0693836932**

KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

SHTOJCA 2

FORMATI I APLIKIMIT (FAZA E PARË)

Dokumentet e dorëzuara		Të dhënat
Të dhënat e agjencisë	Emri i agjencisë	
	Emri i administratorit	
	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar	
Dokumentacioni juridik (dorëzohet bashkëlidhur formatit)	Ekstrakt nga QKB	
	Vendim Gjykate	
	VKM	
	NIPT	
	Statut	
Person Kontakti	Emri	
	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar (nëse ka)	
2.1 Aktiviteti i agjencisë trajnuese (veprimtaritë kyç të agjencisë, bashkëpunimet, numri i punonjësve të agjencisë, fushat që mbulon etj.)		
2.2 Arsyetimi me të dhëna dhe argumente konkrete për nevojën e zhvillimit të programit/moduleve të trajnimit		
2.3 Rëndësinë e programit/modulit të		2.4 Rezultatet e të nxënit që do të arrihen

trajnimi dhe impaktin që do të ketë te mësuesit	nëpërmjet këtij programi ose këtyre moduleve të trajnimit	
2.5 Çfarë përfitojnë nxënësit në sistemin e arsimit parauniversitar nëpërmjet zhvillimit profesional të mësuesve të tyre nëpërmjet këtij programi/moduli trajnimi?		
2.6 Krite të qarta të vlerësimit të arritjeve të mësuesit në fund të trajnimit.		
2.7 Përshkrim i përmbledhur i ekspertizës dhe aftësive të secilit trajner. <i>Bashkëlidhur CV-të e trajnerëve për çdo modul sipas modelit EUROPASS.</i>		
Trajneri 1		
.....		
.....		
2.8 Bashkëpunime me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.		
2.9 Listën e moduleve të akredituara më parë, sipas viteve përkatëse (nëse ka)		
Module të akredituara më parë	Viti i akreditimit	Numri punonjësve arsimorë që ka trajnuar kjo agjenci për secilin prej moduleve të akredituar më parë (nëse ka)
.....		

SHTOJCA 3

LISTA PËRMBLEDHËSE E MODULEVE

Programi i trajnimit: (nëse ka)	
Titulli i modulit të trajnimit	Emrat e trajnerëve për modulin e trajnimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4186/5 Prot.

Tiranë, më 30.8. 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

Rruga "Naim Frashëri", nr.37

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), me anë të Memo-s nr.4186 prot., datë 30.7.2021, me lëndë "Për miratimin e dokumentit "Shpallja e interesit për trajnim të punonjësve mësimor"", lutemi, bashkëlidhur dokumenti i miratuar.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 4186/4 Prot.

Tiranë, më 30. 8. 2021

MIRATOHET



SHPALLJA E INTERESIT PËR TRAJNIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR PERIUdhËn

Bazuar në udhëzimin nr. 16, datë 28.07.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar kanë hartuar dokumentin “Shpallja e interesit për trajnim të punonjësve arsimorë”. Hartimi i këtij dokumenti ka marrë në konsideratë:

- ✓ prioritetet për të zbatuar kurrikulën e reformuar me bazë kompetencat,
- ✓ standardet profesionale të mësuesit miratuar me urdhër nr. 246 datë 24.07.2020,
- ✓ raportin kombëtar të identifikimit të nevojave të mësuesve të hartuar nga ASCAP, 2021,
- ✓ studimet për cilësinë e zbatimit të kësaj kurrikule të perceptuar nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit,
- ✓ rezultatet e mësuesve në procesin e kualifikimit,
- ✓ raportet e monitorimeve të agjencive trajnuese që kanë akredituar module trajnimi.

Për ta bërë sa më gjithëpërfshirës këtë proces, është marrë mendimi i shumë aktorëve që kontribuojnë në sistemin arsimor. Ky dokument është bazuar edhe në rekomandime dhe gjetje të mbledhura nga analiza të brendshme dhe të jashtme për zhvillim profesional të

punonjësve arsimorë të kryera nga UNESCO, UNICEF, ASCAP, QSHA, donatorë, agjenci trajnuese etj.

Dokumenti bazohet edhe në raportin e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit (KAPT) lidhur me temat e moduleve të akredituara nga agjencitë trajnuese, si dhe numrin e tyre për çdo fushë të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë.

Sfidat në arsim, kanë nisur me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në vitin 2015 (pilotimi i kurrikulës ka nisur që nga viti 2014), pikërisht për të nxitur te nxënësit të nxënës të bazuar në kompetenca. Zbatimi i kësaj kurrikule *kërkon një qasje të re të menduarit dhe të organizimit të procesit të mësimdhënies*, të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe të organizimit të procesit mësimor në shkollë. Zhvillimi i vazhduar profesional i stafëve mësimorë dhe përgatitja e tyre për një mësimdhënie me në qendër nxënësin kanë qenë *në fokus, me qëllim që të përballohet* në mënyrë sa më cilësore zbatimi i kësaj kurrikule.

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka prekur çdo fushë të veprimtarisë në arsim dhe të gjithëve na është dashur të përshtatemi me këtë ndryshim të papritur duke vendosur më shumë fokusin në *përdorimin e teknologjisë* për realizimin e procesit mësimor.

Ky dokument i adresohet:

- institucioneve të arsimit të lartë që përgatisin mësues;
- ASCAP-it;
- QSHA-së;
- DRAP-ve;
- ZVAP-ve dhe institucioneve arsimore;
- agjencive trajnuese;
- punonjësve arsimorë.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas prioriteteve fushat dhe çështjet kryesore, të identifikuara si nevoja për zhvillim profesional të personelit arsimor për periudhën 2021-2025.

FUSHAT	ÇËSH TJET KRYESORE SIPAS FUSHAVE ¹
PËRDORIMI TIK NË MËSIMDHËNIE – NXËNIE	- Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie – nxënie. - Përdorimi i pajisjeve DEMO në klasë dhe në lëndë të ndryshme. - Përdorimi praktik i laboratorit virtual në klasë. - Përdorimi i CD-ve dhe i metodave ndërvepruese. - Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik në shkollë. - Mjetet digjitale në mësimdhënie dhe nxënie. - Përdorimi i platformave online si metodologji mësimdhënieje. - Përdorimi i micro:bit për zhvillimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore. - Arsimi i kombiuar (Blended learning)
KURRIKULA	- Të njohurit dhe të kuptuarit e mjeteve të komunikimit (Media literacy) - Planifikimi i kurrikulës. - Planifikimi sipas nevojave të nxënësve (nxënës me nevoja të veçanta). - Kompetencat kyç, kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit. - Burimet e të nxënit. - Planifikimi i veprimtarive mësimore. - Sigurimi i koherencës së planifikimit. - Trajtime të përmbajtjes shkencore sipas fushave/lëndëve.
MËSIMDHËNIA - TË NXËNIT- VLERËSIMI I NXËNËSIT	- Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në kompetenca. - Vlerësimi për të nxënë dhe vlerësimi i të nxënit. - Raportimi i progresit dhe i arritjeve të nxënësve (format e raportimit). - Teknikat e të pyeturit dhe diskutimet.

¹ Çështjet nuk lidhen domosdoshmërisht me temat e modulit, por paraqiten për të zbërthyer fushën përkatëse.

ETIKA, KOMUNIKIMI DHE PEDAGOGJIA	- Hartimi i testeve formuese, hartimi i testeve përmbledhëse.
	- Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA).
	- Metodatat e mësimdhënies dhe nxënies për nxënës me nevojat të veçanta.
	- Mësimdhënia në klasat kolektive dhe puna me nivele të ndryshme nxënësish.
	- Mësuesit ndihmës.
DREJTIMI I SHKOLLËS DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE	- Menaxhimi i klasës dhe i konflikteve.
	- Roli i psikologut shkollor.
	- Aftësitë kros (soft skills) – aftësitë drejtuese, puna në grup, aftësi komunikimi, zgjidhja problemore, mendimi kritik dhe krijues, etika e punës, fleksibilitet dhe përshtatje, aftësitë intrapersonale, etj.
	- Mjedisi fizik i klasës.
	- Klima në klasë.
GJITHËPËRFSHIRJA	- Komunikimi me nxënësit, prindërit, kolegët
	- Drejtuesit e rrjeteve profesionale.
	- Formimi i trajnerëve dhe i specialistëve të vlerësimit lidhur me risitë kurrikulare.
	- Standardet e mësuesit, standardet e drejtuesit.
	- Roli i mentorit dhe zhvillimi i praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.
	- Arsimi gjithëpërfshirës
	- Nxënësit me nevojat të veçanta
	- Mirëqënia e nxënësve
	- Emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore.
	- Media dhe informimi duke përfshirë edhe situatën e krijuar nga pandemia COVID 19.
	- Burimet për të mbështetur procesin e të nxënës

	dhe pjesëmarrjen.
	- Përkrahja e diversitetit.
	- Bullizmi.
	- Zhvillimi i qëndrueshëm.
	- Bashkëpunimi me komunitetin.
	- Partneriteti mësues-nxënës –prindër.